



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 4.7.2019

- Lënda:** Shtesë ankimi i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63, neni 67 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit
- Depozituar pranë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Komisioneri Publik parashtroi në vijim shkaqet shtesë të ankimit të datës 26.10.2018, për sa i përket rivlerësimit të kriterit pasuror të vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

Komisioneri Publik, më datë 26.10.2018, në konsideratë dhe të rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (*referuar në vijim si Komisioni*), për subjektin e rivlerësimit z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë. Ankimi është bazuar, duke vlerësuar nëse vendimmarrja është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të akteve dhe provave të përcjella nga Komisioni, në format elektronik (CD), në Institucionin e Komisionerëve Publikë.

Në këto kushte, Komisioneri Publik, brenda afatit të ngjeshur kohor 15-ditor nga marrja dijeni, ka paraqitur pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit shkaqet e ankimit kundër vendimit nr. 62/2018, me qëllim kontrollin dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë së

subjektit të rivlerësimit. Në ankimin e datës 26.10.2018, ndër të tjera, është argumentuar mungesa e të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortes), për shumën prej 15.130 euro, si këst i paguar në zbatim të kontratës së sipërmarrjes së datës ***.5.2005, dhe gjithashtu është argumentuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, për të justifikuar bindshëm krijimin me të ardhura të ligjshme të pasurive të personave të tjerë të lidhur.

Komisioneri Publik, ashtu sikurse e ka parashtruar dhe në kërkesën për rivendosje në afat, më datë 21.6.2019, u njoh me dy analiza financiare të realizuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, të cilat paraqesin rezultate të ndryshme mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Komisioneri Publik, në kohën e përgatitjes së ankimit të datës 26.10.2018, nuk ka qenë në dijeni të ekzistencës së këtyre analizave financiare dhe qëndrimit të Komisionit ndaj rezultateve të tyre, pasi këto analiza nuk kanë qenë pjesë e akteve të administruara në dosjen e përcjellë nga Komisioni.

Në dritën e këtyre fakteve të reja, të vëna në dispozicion rishtazi, Komisioneri Publik ka kryer analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003 - 2016. Analiza financiare është hartuar mbështetur në: (i) deklaratimet periodike vjetore, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe deklaratimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ mbi kursimet në *cash* dhe shpenzimet e realizuara; (ii) dokumentacionin zyrtar mbi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëshortes së tij, të vënë në dispozicion nga institucionet përgjegjëse¹; (iii) të dhënat mbi shpenzimet e konsumit për njësinë ekonomike familjare, sipas INSTAT-it për periudhën 2003 – 2016; (iv) të dhënat e sistemit TIMS mbi hyrje-daljet e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, si dhe në përgjigjet e subjektit, në pyetësorin nr.***, mbi udhëtimet e të bijave (në mungesë të të dhënave nga sistemi TIMS për këto të fundit); (v) të dhënat nga bankat e nivelit të dytë, për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij.

Nga analizimi i këtyre të dhënave, krahas pamjaftueshmërisë së mbulimit me burime të ligjshme për pagesën e këstit 1 të apartamentit në vitin 2005, analizuar në pikën 16, 17 të ankimit të datës 26.10.2018, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara edhe për vitet 2007, 2008, 2009, 2011, në një diferencë negative në shumën totale prej 1.295.093 lekë.

Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore rezulton se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar saktë kursimet në *cash*, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për këto kursime, dhënë gjatë hetimit administrativ, nuk përputhen me deklaratimet periodike vjetore, të vëna në dispozicion nga ILDKPKI, konkretisht:

1. Në **DV-2005**, nga aktet në fashikullin e ILDKPKI-së, nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar kursimet në *cash* dhe depozitë bankare në emër të bashkëshortes. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka paraqitur një kopje të faqes nr. 3 të DV-2005 të personit të lidhur, ku pasqyrohen të deklaruara kursime në llogaritë bankare në emër të bashkëshortes, respektivisht në shumat 100.000 lekë (depozituar në ***); 1.500 euro (depozituar në *** Bank), si dhe kursime në *cash*, në shumën 450.000 lekë. (Lidhur me këtë vit nga

¹ Korrespondenca e Komisionit me DRT Tiranë, me shkresë nr. prot. ***, datë ***.2.2018, si dhe korrespondenca e ILDKPKI-së me DRT Tiranë, me shkresë nr. prot. ***, datë ***.9.2017.

Komisioneri Publik, në ankimin e datës 26.10.2018, është konstatuar pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të paguar këstin e apartamentit në shumën 15.130 euro.)

2. Në **DV-2009**, në faqen nr. 10, ku kërkohen të deklarohen shtesa dhe pakësime të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, në deklaratën e personit të lidhur/bashkëshortes rezulton se është deklaruar: *2.000 euro të depozituara në *** Bank*. Në të njëjtën faqe është deklaruar *30.000 euro të ardhura nga veprimtaria noteriale*. Për këto të ardhura të deklaruara nga aktiviteti noterial i bashkëshortes, nuk deklarohet se sa është shuma e kursyer nga këto të ardhura (sikundër deklarohet në deklaratat e viteve përpara dhe pas kësaj periudhë deklarimi) apo nëse kursimi është administruar në *cash*. Kjo shumë, sipas deklarimeve të subjektit, është pjesë përbërëse e shumës së depozituar në vitin 2014, në llogarinë/depozitën bankare në emër të bashkëshortes (e deklaruar nga subjekti në D-Vetting: derdhje 79.700 euro me burim: *...nga pakësimi i cash-it të deklaruar më parë*).
3. Në **DV-2010**, në faqen 11, ku kërkohen të deklarohen shtesa dhe pakësime të pasurive, nuk rezulton që subjekti apo bashkëshortja të kenë deklaruar kursime në *cash*. Ndërkohë, në shpjegimet e tij ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka poseduar *cash* në banesë, në fund të vitit 2010, edhe shumën prej 10.450 euro, të tërhequr nga *** Bank. Edhe kjo shumë është pjesë përbërëse e shumës së depozituar në vitin 2014 në llogarinë/depozitën bankare në emër të bashkëshortes (e deklaruar nga subjekti në D-Vetting: derdhje 79.700 euro me burim: *...nga pakësimi i cash-it të deklaruar më parë*. Për këtë vit shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, nuk përputhen me deklaratimet periodike vjetore.
4. Në **DV-2011**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash* 1.200.000 lekë nga të ardhurat nga aktiviteti noterial. Shpjegimet e tij gjatë hetimit administrativ nuk përputhen me deklaratimin në DV-2011, pasi në këto shpjegime subjekti deklaroi që gjendja totale e kursimeve, të disponuara në banesë në fund të vitit 2011, ka qenë 1.200.000 lekë, si rezultat i pakësimit të kursimeve të mëparshme, pakësime që nuk i ka deklaruar në deklaratimet periodike vjetore deri në këtë vit.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, deklaratimet e pasakta mbi kursimet *cash* ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare të subjektit dhe bashkëshortes së tij, për krijimin e pasurisë *Depozitë pranë ****, në emër të bashkëshortes, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DV-2014 dhe D-Vetting.

Nisur nga sa më sipër është konstatuar, nisur dhe nga fakti se dy analizat financiare, provat e reja me të cilat është njohur Komisioneri Publik, paraqesin rezultate të ndryshme mbi mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurive të deklaruara në D-Vetting, Komisioneri Publik vlerëson se një rrethanë e tillë duhet t'i nënshtrohet kontrollit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Komisioneri Publik, në konsideratë të faktit se Kolegji i Posaçëm i Apelimit, është organi i vetëm gjyqësor në procesin e rivlerësimit, që në funksion të shqyrtimit të ankimit, zgjidh çështjen në mënyrë përfundimtare, do të vlerësonte kryerjen nga ana e Kolegjit të një

analize të plotë dhe përfundimtare financiare, në vlerësim të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që dhe në vendimin e arsyetuar nuk përmendet pamjaftueshmëria e subjektit të rivlerësimit në mbulimin më burime të ligjshme të pasurive të deklaruara në D-Vetting, por ndër të tjera është konkluduar se: *subjekti arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezultoi të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme.*

Arsyetimi i mësipërm është në plotësim të shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik të datës 26.10.2018, që, në tërësinë e tyre dhe në unitet me njëri-tjetrin, përbëjnë bazën mbi të cilën, pas rivlerësimit të kriterit të pasurisë, dalim në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të deklaruara në Deklaratën Vetting, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

Për sa më sipër, në zbatim të dispozitave përkatëse të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm, Komisioneri Publik vlerëson se vendimi nr. 62/2018 i Komisionit është i cënueshëm në tërësinë e përmbajtjes së tij, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, shkak për të cilin i kërkohet Kolegjit të ushtrisë juridiksionin e tij kontrollues dhe rivlerësues mbi faktet e reja të paraqitura, në kushtet e një vlerësimi të plotë dhe të gjithanshëm për kriterin e pasurisë, të shtrirë në të gjitha pasuritë e subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA